

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-061/14**

Prishtinë, 24 Shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

**K.R.**

Blok Save Kovacevica 35/P, apartament no.6

Krnjaca, Beograd

Republika e Serbisë

**Pala ankuese**

Kundër

**Sh.K.**

Përfaqësuar nga av. Q.F.

Decan

Kosove

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14497) të datës 11 qershor 2013), pas shqyrtimit të mbajtur më 24 Shkurt 2016, mori këtë:

**AKTGJYKIM:**

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e K.R. e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 të datës 11 qershor 2013.**
2. **Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 i datës 11 qershor 2013 për sa i përket KPA14497.**

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 27 Tetor 2006 K.R. (këtu e me tutje: pala ankuese), ka paraqitur një kërkesë si anëtare e bashkësisë familjare te bartësit te pretenduar te se drejtës pronësore, Miodrag Radulović bashkëshortit te saj dhe ka kërkuar ri-posedimin e një banese me sipërfaqe 29 m2, qe ndodhet në një ndërtesë banimi në rrugën Marsala Tita nr.37/4 ne Pejë/Pec (këtu e me tutje: prona e kërkuar) si dhe kompensim për demin e shkaktuar nga përdorimi pronës . Pala ankuese theksoi se prona e kërkuar ishte humbur si pasoje e konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke cekur 26 Qershorin 1999 si datën e humbjes Kërkesa është regjistruar në Agjencinë Kosovare te Privatizimit(këtu e me tutje: AKP) me numrin KPA14497.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese ka dorëzuar këto dokumente:
  - Certifikatën e martesës nr.101, date 27 prill 1976 lëshuar nga Komuna e Pejës qe dëshmon se bartësi i te drejtës pronësore është bashkëshorti i palës ankuese;
  - Certificate vdekjeje nr.00578, date 3 Tetor 2006 lëshuar nga bashkia e Beogradit, qe vërteton se bashkëshorti i palës ankuese ka ndërruar jete ne 8 Tetor 2006.
  - Vendim nr. 01-351/728, date 20 Mars 1998 lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Banesa Komunale, Ndërtimit, Pronës dhe Çështjet Ligjore ne Komunën e Pejës. Me ane te këtij vendimi bashkëshortit te palës ankuese ishte lejuar te ndërtonte pronën e kërkuar.
3. Dokumentet e mësipërme janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.
4. Prona e kërkuar është verifikuar fizikisht më 12 Korrik 2007. Nga verifikimi rezultoi se prona ishte e uzurpuar nga Sh.K. (më tutje: pala përgjegjëse ne ankese), i cili deklaroi se është duke e shfrytëzuar pronën për qëllime banimi dhe pretendoi se ka investuar mbi pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse ne ankese më 12 Korrik 2007, ai nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes.

5. Pala përgjegjëse ne ankese e kundërshtoi kërkesën. Për t'i mbështetur pretendimet e veta, pala përgjegjëse ne dorëzoi këto dokumente:
- Kontratën vr.nr.2155/03 date 20 Mars 2003 e lidhur midis M.R. (bashkëshorti i palës ankuese) i përfaqësuar nga M.R. dhe Sh.K. t, i përfaqësuar nga K.B.. Kontrata e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale e Pejës vërteton pronari i pronës objekt kontesti me vullnet te lire i ka shitur këtë prone palës përgjegjëse ne ankese për një çmim prej 22 500 euro. Nga raporti i konsoliduar i verifikimit i datës 30 Qershor 2011, rezulton se kontrata e paraqitur është vërtetuar pozitivisht nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-se.
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (këtu e me tutje: KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, me Vendimin KPCC/D/R/207/2013, të datës 11 Qershor 2013, ne paragrafët 16, 17 dhe 56 vendosi që ta hedhë kërkesën e K.R. , me arsyetimin se e drejta pronësore mbi pronën e kërkuar nuk ka humbur për shkak te konfliktit, por si rezultat i transaksionit vullnetar te shitjes se pronës. Si pasoje kërkesa është jashtë juridiksionit te KKPK edhe kërkesa për kompensim hidhet poshtë.
7. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 7 Nëntor 2013. Pala përgjegjëse ne ankese mori dijeni për vendimin e KKPK-se me date 5 Nëntor 2013, nëpërmjet avokatit te tij Q.R.
8. Më 2 Dhjetor 2013, pala ankuese, dorëzoi një ankesë në Gjykatën Supreme duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së. Së bashku me ankesën, pala ankuese paraqiti dokumentet te njëjta me ato që ka paraqitur para AKP-së.

### **Pretendimet e palëve**

9. Pala ankuese, me ankesën e saj i referohet vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe shkeljes serioze të së drejtës materiale dhe procedurale në fuqi, duke arsyetuar se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk e kane shitur pronën e kërkuar. Ajo pretendon se KKPK-ja, gabimisht mund te ketë keqinterpretuar kontratën e cila nuk ka te beje me pronën e kërkuar me sipërfaqe 29 m<sup>2</sup>, por me një prone tjetër me te njëjtën adrese dhe me sipërfaqe 40.24 m<sup>2</sup>. Për këto arsye, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme qe te pranoje kërkesën e saj dhe te vendose ne favor te saj duke i njohur te drejtën e posedimit.

10. Pala përgjegjëse ne ankese, ne përgjigjen e saj sqaron se pretendimet e palës ankuese janë te pabaza, pasi bashkëshorti i palës ankuese nëpërmjet kontratës vr.nr.2155/03 date 20 Mars 2003, me vullnetin e tij te lire ia ka shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse ne ankese. Mbi pronën ne fjale janë kryer punime nga pala përgjegjëse ne ankese

### Arsyetim ligjor

#### *Pranueshmëria e ankesës*

11. Ankesa është e pranueshme, pasi është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç parashikohet ne nenin 12.1 të Rregullores se UNMIK nr.2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (këtu e me tutje: Rregullorja e UNMIK 2006/50).

#### *Juridiksioni*

12. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.
13. Gjykata Supreme vëren se prona e kërkuar është një banesë me sipërfaqe 29 m<sup>2</sup> dhe se burri i palës ankuese ka shitur një prone tjetër ne te njëjtën adresë por me sipërfaqe 40.24m<sup>2</sup>.
14. Pala Ankuese kërkon vërtetimin e të drejtës së tij pronësore mbi pronën e kërkuar, riposedimin dhe kompensim për posedimin ne mënyrë te paligjshme te pronës.
15. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores se UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e viteve 1998/1999, që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të cilat nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti **apo që rezultojnë** nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Pala ankuese pretendon pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe se e ka humbur te drejtën pronësore gjate konfliktit te armatosur ne vitet 1998-1999. Ne përputhje me nenin 7 te Ligjit nr.03/L-006 Mbi Procedurën Kontestimore (këtu e me tutje: LPK) “palët duhet ti paraqesin te gjitha faktet mbi te cilat ato bazojnë kërkesat e tyre dhe te propozojnë prova te cilat vërtetojnë këto fakte”.
17. Pala Ankuese ka arritur te provoje se e ka fituar pronësinë me vendimit nr. 01-351/728, date 5 Mars 1998 lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Banesa Komunale, Ndërtimit, Pronës dhe Çështjet Ligjore ne Komunën e Pejës.

18. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet ankimore të ankueses së bashkëshortit të saj të cilit i është dhënë një banesë me lejuarën për të ndërtuar nën kulm sipas aktvendimit të organit kompetent në sipërfaqe prej 29m<sup>2</sup>(prona e kërkuar), por ajo nuk ka paraqitur fakte dhe nuk ka propozuar prova juridikisht të vlefshme se ai apo bashkëshortja e tij i ka kryer këto punë ndërtimore mbi ndërtimin e këtij nënkulmi në afatin prej një viti ashtu si ka qenë e parashikuar me aktvendimin e theksuar nga ana e saj.

19. Rrjedhimisht, pala ankuese ka dështuar të provojë se ajo e ka humbur pronësinë mbi pronën e kërkuar gjatë apo për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998-1999. Prandaj, Gjykata Supreme pajtohet me përfundimin e vendimit të vendimit të KKPK-së dhe arrin në përfundimin se ankesa është e pabazuar.

20. Në bazë të arsyeve të lartpërmendura në pajtim me nenin 13.3.c të Rregullores së UNMIK 2006/50 dhe nenin 200 të LPK-së, vërtetohet vendimi i KKPK-së dhe refuzohet ankesa si e pabazuar.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**